

Cilësia e silazhit - çfarë ka me të vërtetë vlerë?

Përgatitur nga Franz Riegler, Konsulent i Schaumann dhe Aksioneri i Austria Prämix shpk.

Për të shfrytëzuar më së miri potencialin gjenetik të lopëve të qumështit duhet të optimizohet teknika e të ushqyerit dhe të zbatohen parimet bazë për përgatitjen e silazhit. Respektimi i principeve bazë të teknikave të silazhimit është çelësi për sukses. Cilësia e silazhit pranveror varet nga një sërë faktorësh, ku veçanërisht një rol të rëndësishëm luan përbërja e lëndës së parë. Për cilësinë e silazhit rëndësi ka gjithashtu dhe koha e kositjes si dhe menaxhimi optimal i silazhit.

Parcelat me përbërje të lartë kulturash pranverore kanë një ndikim më të madh në krijimin e acidit laktik nëse vlera e Ph-shit bie, pasi niveli i sheqerit që ato përmbajnë është më i lartë, kjo krahasuar me parcelat me përbërje të lartë barërash bishtajoreve që karakterizohen nga niveli i ulët i sheqerit. Sheqeri përfaqëson sasinë totale të karbohidrateve të fermentueshme që treten në ujë. Kusht kryesor që procesi i fermentimit të jetë optimal është që përmbajtja e sheqerit në masën e freskët të jetë rreth 2%. Megjithatë niveli i sheqerit nuk varet vetëm nga përbërja e lëndës së parë por edhe nga koha e pjekjes dhe gjithashtu nga koha e ekspozuar në fushë. Koha e gjatë e ekspozimit në fushë redukton nivelin e sheqerit në mënyrë ekstreme dhe shoqërohet me humbje frymëmarrje dhe shumim të mykut dhe kërpurdhave.

Vlera e pH-shit

Qëllimi kryesor është realizimi i një procesi të suksesshëm silazhimi brenda 24 orësh duke mbajtur nivelin e tharjes ndërmjet vlerave 30% dhe 40%. Një nivel më i lartë i lëndës së thatë shoqërohet me rritje të masës së thatë. Si pasojë sa më e thatë të jetë lënda, aq më shumë vështirësohet ngjeshja. Aftësia për silazhim varet nga niveli i substancave buferike. Kapaciteti buferik përcakton rezistencën

ndaj aciditetit natyral të prodhuar nga procesi i fermentimit. Sa më i lartë të jetë kapaciteti buferik i lëndës së parë aq më i lartë duhet të jetë niveli i acidit laktik, në mënyrë që të sigurohet reduktimi në masën e duhur i vlerës së pH-shit.

Koha e kositjes

Një tjetër faktor i rëndësishëm për përgatitjen e silazhit optimal është koha e kositjes. Ushqimet e gjelbërta të korrura në faza të hershme të vegetacionit konsumohet më shumë për shkak të përmbajtjes së lartë të energjisë, duke rritur kështu dhe rendimentin e qumështit. Kositja duhet të bëhet në fazën e hershme ose gjatë lulëzimit të parë të bimës dhe jo më vonë se kur përmbajtja e celulozës arrin vlerën 22-23% të lëndës së thatë. Sa më e pjekur të jetë bima, vlerat e saj ushqyese ulen dhe sasia e celulozës rritet, kjo rezulton në uljen e tretshmërisë. Pra, për të ruajtur vlerën ushqyese të ushqimeve voluminoze, duhet që patjetër kositja të bëhet në fazën e hershme ose gjatë lulëzimit të parë të bimës.




Koha optimale e kositjes garanton një përqëndrim më të lartë të energjisë



Shpërndarja e duhur e silazhit është e domosdoshme...



...për një ngjeshje të mirë prej 230 kg/m



Mbulimi i tërthortë me thasë silazhi me një distancë prej 5 m siguron një shtypje të njëtrajtshme

Menaxhimi i silazhit duhet të përshtatet me fermën blegtorale

Zbatimi korrekt i teknikave të silazhimit ndikon në rritjen e rendimentit të prodhimit. Kështu duhet që madhësia e gropës së silazhit të përshtatet me numrin e bagëtive dhe të jetë e mjaftueshme për të përmbushur nevojat ushqimore si në stinën e verës, me një kapacitet ushqimor prej 2,5 m në javë, ashtu dhe në dimër, me një kapacitet ushqimor prej 1,5 m në javë. Nga ana tjetër, nxehja e mëvonshme e silazhit ka një efekt negativ në rezultatin e dëshiruar. Në rastet kur madhësia e silosës është fikse atëherë duhet të aplikohet një sasi e vogël silazhi vere, në mënyrë që të garantohet një sasi e mjaftueshme ushqimi. Dy traktorë bujqësorë, njëri që shpërndan dhe shtyn silazhin dhe tjetri që përzien silazhin duke ecur me një shpejtësi prej max 3km/h kanë rezultuar të dobishëm. Për të arritur një ngjeshje mesatare prej 230kg/m³ duhet që shtresat që janë për t'u shtypur të mos e kalojnë trashësinë prej 30cm. Nga njëra anë duhet që presioni i gomave duhet të jetë 2 bar dhe nga ana tjetër duhen shmangur gomat e dyfishta.

Mbulimi dhe izolimi i gropës së silazhit

Pas shtypjes silazhi duhet të mbulohet menjëherë në mënyrë që të izolohet nga ajri. Qëllimi i mbulimit me një shtresë thithëse nën mbulesën normale të silazhit është që të eliminohet depërtimi i dëmshëm i oksigjenit. Mbulimi i masës së silazhuar pengon depërtimin e lagështirës dhe nuk lejon depërtimin e ajrit, edhe pse gjatë ditës së nesërme sasia për silazhim duhet të shtohet , gjatë natës duhet të mbulohet patjetër me një shtresë mbrojtëse. Shtresa e fundit mbrojtëse për silazhin siguron mbrojtje kundër zogjve dhe dëmeve të tjera. Gjithashtu është e rëndësishme që silosi të mbyllet mirë nga të gjitha anët në mënyrë që të mos depërtojë oksigjeni.

Sistemi 5-metërs konsiderohet i suksesshëm. Rreth $\frac{3}{4}$ e thasëve të silazhit duhet të jenë të mbushura me zhavor, me qëllim që rrjedhja e ujit të mos pengohet dhe njëkohësisht të shmanget ngrirja. Një shtypje e njëtrajtshme sigurohet vetëm nëse fillohet anash dhe silazhi mbulohet në mënyrë të rregullt çdo 5 metër me thasë. Gazrat nga fermentimi nxjerrin në pah punën e kujdesshme që është bërë gjatë mbulimit të silazhit dhe nuk është e lejueshme në asnjë mënyrë që gazi të

dalë jashtë. Të gjitha masat e sipërpërmendura të marra së bashku janë të domosdoshme për përfitimin e një silazhi cilësor.

Kujdes nga ushqimi i kontaminuar

Mykotoksinat: Kafshët në ferma, veçanërisht derrat që konsumojnë me rrezik me të lartë kontaminimi , janë të rrezikuar nga mykotoksina. Në Austri aplikohet një program për të vëzhguar praninë e mykotoksinës në misër.

Një pamje e qartë rreth pranisë së mykotoksinës në ushqimet e fermës mundësohet vetëm nëpërmjet eksperimenteve laboratorike. Ka mykotoksina të ndryshme të cilat kanë dhe efekte të ndryshme dhe si pasojë simptoma të ndryshme sëmundjesh. Misri kryesisht kontaminohet me mykotoksinë nga myku i zakonshëm i pranishëm në drithërat e freskëta, Fusarium. Tek ushqimi i derrave duhet t'i kushtohet vëmendje e madhe para së gjithash deoxynivalenol (DON), zearalenon (ZEA) fumonisinen (FUM) dhe aflatoksinave (AFLA).

Kafshët që mbahen për riprodhim dhe gicat reagojnë në mënyrë më të ndjeshme ndaj ushqimit të kontaminuar krahasuar me derrat e majmur. I rrezikshëm është Zearalenon-i , i cili është përgjegjës për çrregullime të ndryshme në pjellori. Në praktikë vërehet shpesh, veçanërisht te gicat, pjesë të enjtura dhe të skuqura, gjithashtu dhe shumë aborte, të cilët përkeqësojnë rendimentin në prodhim. Prania e Deoxynivalenol në ushqim, në varësi dhe të sasisë, sjell ulje të konsumit të ushqimit, madje dhe refuzimin total të tij. Te derrat e majmë ai shfaqet shpesh me të vjella. Sjelljet agresive çojnë në kafshime dhe në sulme ndaj njëritjetrit dhe nga të gjitha këto së bashku dobësohet sistemi imunitar, duke favorizuar kështu dhe infeksionet sekondare. Përkeqësimi i shëndetit të kafshëve sjell vështirësi tregëtimi dhe dëme ekonomike për fermerët.

Edhe pse monitorimi kryhet në kohë, është e këshillueshme që ushqimi të analizohet për të vëzhguar praninë e mykotoksinës, me qëllim që të sigurohet shëndeti i mirë i kafshëve blegtorale dhe të shfrytëzohet prodhimtaria e tyre. Normalisht duhet që të gjithë fermerët e derrave të kenë informacion mbi komponentët e ushqimit, pasi kostot që lidhen me ushqimin janë një nga më të

larta përsa i përket mbajtjes së derrave. Kjo do të thotë që analizimi i ushqimit për lëndë ushqyese është mjaft fitimprurëse. Çdo vit shfaqen luhate, veçanërisht përsa i përket nivelit të proteinës dhe lëndës së lëngshme në ushqim. Dhoma e Bujqësisë dhe Grupi Këshillues i Punës për rritjen e derrave ndërmarrin çdo vit iniciativa ku të interesuarit mund të marrin informacione se si krijohen racionet sipas nevojës dhe me kosto të levërdisshme.